



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 766 Akti

Nr. 782 Vendimi
Tiranë, më 10.7.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në datën 9.7.2024, ora 10:00 në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Besmir Rrapaj**, me detyrë ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Besmir Rrapaj, me detyrë ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 9.7.2024 kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Besmir Rrapaj gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
2. Z. Besmir Rrapaj u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 15.6.2021 nga Komisioni, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, me trup gjykues të përbërë nga komisionerët Lulzim Hamitaj, Etleda Çiftja dhe Firdes Shuli.
3. Gjatë hetimit administrativ është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët. Me anë të postës elektronike të datës 15.7.2021, ka konfirmuar mospasjen e ndonjë konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues që i ishin bërë me dije.
4. Në vijim, pasi të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit, me vendimin nr. 1, datë 18.6.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
5. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:
 - a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016 pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
 - b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016 pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (ish-DSIK, në vijim AKSIK), brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
 - c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016 pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.
6. Me vendimin nr. 2, datë 21.6.2024, Komisioni vendosi të mbyllë hetimet dhe, në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.
7. Në datën 21.6.2024, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi atë për t’u njohur me dosjen dhe provat e administruara (nëse e vlerësonte të nevojshme), në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 e 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të

paraqitur shpjegimet e kërkuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 24.6.2024. Subjekti paraqiti shpjegimet e veta brenda afatit të caktuar nga Komisioni.

8. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet vendimit nr. 3, datë 4.7.2024, vendosi caktimin e seancës dëgjimore në datën 9.7.2024, duke e njoftuar subjektin përmes postës elektronike për këtë vendimarrje.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 9.7.2024, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler.
10. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti Besmir Rrapaj parashtrroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 9.7.2024 u mbyll, për të rifilluar më 10.7.2024 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës së dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancë dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

14. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
15. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

1. Automjet tipi “Opel Frontera”, blerë në vitin 2011, në vlerën 200.000 lekë

16. Subjekti ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015, si dhe në deklaratën *Vetting*, pasurinë e llojit automjet të përfituar nëpërmjet kontratës nr. ***/***, datë 21.11.2011, në shumën 200.000 lekë nga shtetasi E. Rr.¹ (vëllai i subjektit). Për krijimin e kësaj pasurie, subjekti nuk e ka deklaruar burimin financiar.
17. Nga DPSHTRR-ja² është përcjellë dosja e automjetit në fjalë³, nga shqyrtimi i së cilës është konfirmuar sa më sipër deklaruar nga subjekti. Gjithashtu, është konstatuar se me anë të kontratës së dhurimit nr. ***/ ***, datë 1.9.2018, automjeti në fjalë i është dhuruar nga subjekti shtetasit M. Rr.⁴.
18. Nga të dhënat e sistemit TIMS të përcjella nga DPPSH⁵-ja, si dhe nga të dhënat e përcjella nga AMF⁶-ja, nuk kanë rezultuar automjete të tjera në përdorim nga ana e subjektit, të ndryshme nga ai i deklaruar në pronësi të tij.
19. I pyetur nga Komisioni lidhur me burimin e krijimit për blerjen e automjetit në analizë, subjekti ka deklaruar se si burim kishin shërbyer të ardhurat e përfituara nga punësimi në Itali, në kompaninë e vëllait të tij⁷, për periudhën 17.12.2010 – 19.2.2011, lidhur me të cilat subjekti ka paraqitur një deklaratë nga vëllai i tij për marrëdhënien e punësimit, si dhe vërtetimi nga ISSH-ja dhe INPS, ku evidentohen të ardhurat e realizuara prej tij ndër vite.
20. Në vijim, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se pagën për punësimin pranë shoqërisë së vëllait e ka marrë nëpërmjet bankës “****” “****”, e cila aktualisht nuk ushtron më aktivitet (ka falimentuar). Po ashtu, subjekti është shprehur se nuk disponon dokumentacion mbi të ardhurat nga punësimi i tij në Itali, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar.
21. Për sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me burimin e krijimit të pasurisë automjet. Referuar deklarimeve të subjektit në pyetësorin nr. 2, se *de facto* ka

¹ Kthim përgjigje nr. ***, datë 21.2.2024, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 15.1.2024.

³ Kontratë shitjeje automjetit nr. ***/***, datë 21.11.2011, për automjetin tip “Opel Frontera”, me targë ***. Blerës: Besmir Rrapaj. Shitës: E. Rr. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 22.11.2011, për automjetin tip “Opel Frontera”, me nr. shasie ***, me targë ***, në pronësi të B. Rr.

⁴ Referuar të dhënave sipas certifikatës së gjendjes civile, ka rezultuar se nëna e subjektit e ka pasur mbiemrin e vajzërisë “Rr.”, pra bëhet fjalë për një të afërm të subjektit.

⁵ Me përgjigjen nr. ***, datë 31.1.2014.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.1.2024.

⁷ Dokument i të ardhurave nga Italia – INSP për burimin e blerjes së automjetit; leje qëndrimi në emër të subjektit.

jetuar me prindërit në këtë periudhë⁸, Komisioni ka përfshirë në analizë, veç të ardhurave të tij dhe bashkëshortes, edhe të ardhurat e nënës nga pensioni sipas ISSH-së, si dhe ka përllogaritur shpenzimet jetike për 3 persona.

22. Nga analiza e kryer subjekti ka rezultuar me burime të mjaftueshme financiare për blerjen e automjetit në vitin 2011, siç paraqitet në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim.

Tabela nr. 1 – Analiza financiare për blerjen e automjetit në datën 21.11.2011

Te ardhura nga paga e subjektit	721 995
Te ardhura nga pensioni nëna e subjektit	219 499
Totali i të ardhurave	941 494
Shpenzime jetese	111 885
Shpenzime udhetimi	101 927
Blerje makine	200 000
Totali i Shpenzimeve	413 812
Rezultati në datë 21.11.2011	527 682

23. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë automjet as në DIPP-në e vitit 2015 dhe as në deklaratën *Vetting*. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Kolegjit⁹, trupi gjykues çmon e sjell në vëmendje se pasaktësitë në deklaratimet periodike, të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit.
24. Për sa më sipër, kjo pasaktësi nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 e, për rrjedhojë, nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë ai nuk rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë në analizë.

2. Apartament me sip. 56. m², ndodhur në *, ***, në bashkëpronësi**

25. Në DIPP-në e vitit 2016 dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament me nr. ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 56 m², me vendndodhje në ***, ***, Vlorë, në bashkëpronësi në masën ¼, sipas certifikatës së pronësisë së datës 13.12.2016.
26. Si burim për krijimin e kësaj pasurie subjekti ka deklaruar trashëgiminë ligjore, sipas dëshmisë së trashëgimisë së babait të tij B. Rr.¹⁰, me nr. ***, datë 23.8.2016.
27. Lidhur me origjinën e kësaj prone, referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, është konstatuar se në datën 5.11.1993 i ndjeri B. Rr. ka nënshkruar kontratën nr. *** me Ndërmarrjen Komunale të Banesave, sipas ligjit nr. 7652,

⁸ Kjo mënyrë përllogaritjeje është bërë për efekt standardi duke ruajtur metodologjinë si praktikë, pasi rezultati financiar në raport me këtë pasuri del pozitiv edhe nëse analiza do të kryhej veçmas, sipas certifikatës familjare.

⁹ Vendimi nr. 26/2023, nr. 28/2020 (JR), datë 23.10.2020; nr. 37/2021 (JR); nr. 34/2022 (JR).

¹⁰ Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 13.12.2016, për apartament në *** me sip. 56 m², në pronësi të B., E., L. dhe Sh. Rr., shoqëruar me kartelën e pasurisë dhe hartën treguese të regjistrimit me pjese takuese ¼; kontratë për privatizimin e banesës datë 5.11.1993, me palë B. Rr. dhe NK Banesave. Vlera 8.784 lekë; kontratë shitjeje datë 5.11.1993. Vlera 8.784 lekë; vërtetim noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.5.1994; formular nr. ***, "Shtesore për apartament"; planimetria e apartamentit; dëshmi trashëgimie ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.8.2016, me trashëgimlënës B. Rr. për trashëgimtarët Sh., E., L. dhe B. Rr.

datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, për blerjen e apartamentit në vlerën 8.784 lekë, vërtetuar sipas mandatit nr. ***, datë 5.11.1993.

28. Lidhur me statusin juridik aktual të pasurisë, bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. *** kol., datë 23.8.2016, konfirmohet se trashëgimtarët e kësaj pasurie janë bashkëshortja e të ndjerit, znj. Sh* Rr*, dhe tre fëmijët e tij (B., E. dhe L. Rr.), të cilët trashëgojnë ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore.
29. ZVRPP Vlorë, me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2018, ka përcjellë dokumentacionin e pasurisë në analizë pranë ILDKPKI-së, nga shqyrtimi i së cilës është konfirmuar sa më sipër deklaruar nga subjekti¹¹.
30. Nga FSHU-ja¹² është konfirmuar një kontratë në emër të znj. Sh. Rr., e lidhur më 15.3.2007, me nr. ***, me adresë ***, Qarku Vlorë, si dhe një kontratë në emër të subjektit Besmir Rrapaj, e lidhur më 11.9.2019, me nr. ***, në instancën Tiranë me adresë: Rruga e ***, ***, Njësia Administrative Nr. ***, ***, lëshuar në datën 12.7.2019. Kjo adresë përputhet me deklarinimin e subjektit në pyetësorin nr. 1, ku ka deklaruar se në datën 28.9.2018 ka blerë një apartament në shumën 83.000 euro, i cili trajtohet në rubrikën “Konstatime të tjera”.
31. Nga UKT-ja¹³ është konfirmuar kontrata në emër të subjektit për pasurinë e blerë prej tij në vitin 2018.
32. Nisur nga sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me pasurinë apartament të përfutur nëpërmjet procedurave të privatizimit në vitin 1993.

3. Lidhur me gjendjen *cash* të deklaruar nga subjekti në shumën 900.000 lekë

33. Subjekti ka deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2015 gjendjen *cash* në shumën 800.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar se gjendja *cash* është shtuar në shumën 100.000 lekë. Më pas, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 900.000 lekë. Nga shqyrtimi i deklaratave të sipër cituara është konstatuar se subjekti nuk ka deklaruar burimin financiar përkatës.
34. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2¹⁴ subjekti ka sqaruar se si burim për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 800.000 lekë, kishin shërbyer të ardhurat e përfutur nga punësimi i tij në Itali dhe Shqipëri ndër vite, si dhe të ardhurat e bashkëshortes. Lidhur me gjendjen *cash* në vlerën 100.000 lekë, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 subjekti ka sqaruar se bëhet fjalë për shtesë në atë vit dhe jo për gjendjen *cash* të akumuluar. Po ashtu, në këtë pyetësor subjekti ka specifikuar se si burim për krijimin e gjendjes *cash*, kishin shërbyer kursimet familjare.
35. Komisioni ka kryer analizën financiare të të ardhurave dhe të shpenzimeve të subjektit¹⁵ dhe bashkëshortes, bazuar në të dhënat sipas vërtetimit të INPS (Instituti Kombëtar i

¹¹ Komisioni i ka dërguar tri kërkesa ASHK-së Vlorë (e fundit në datën 24.5.2024) dhe nga ky institucion nuk është përcjellë dokumentacioni përkatës.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2023.

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.12.2023.

¹⁴ Lista e kontributeve e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore për shtetasit Besmir Rrapaj dhe L. Rr.; dokumenti i të ardhurave nga INSP; leje qëndrimi italiane në emër të subjektit.

¹⁵ Referuar dokumentacionit të administruar lidhur me të ardhurat e subjektit ka rezultuar se subjekti ka qenë i punësuar: (i) në Itali pranë shoqërisë së vëllait të tij “****” (për periudhën 2011 – 2013); (ii) të ardhura nga Shërbimi Përmbarimor *** (shtator 2012 – janar 2014); (iii) të ardhura nga Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuet (janar 2014 – shtator 2014); të

Sigurimeve Shoqërore, për periudhën e punësimit në Itali) të datës 17.1.2019, si dhe bazuar në të dhënat e përcjella nga ISSH-ja¹⁶. Gjithashtu, në analizën financiare janë përfshirë edhe të ardhurat e nënës nga pensioni për periudhën maj – dhjetor 2011, gjatë së cilës ajo ka bashkëjetuar me subjektin.

36. Nga shqyrtimi i vërtetimit të INPS-it të datës 17.1.2019 janë konstatuar disa mospërputhje mes periudhave të punësimit dhe ditëve të qëndrimit të subjektit në Itali (sipas sistemit TIMS-it¹⁷). I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti ka shpjeguar se deklaratimet lidhur me marrëdhënien e punësimit të tij (sikurse edhe ndërprerja e kësaj marrëdhënie) pranë shoqërisë “****” janë kryer nga vëllai i tij, i cili është pronari i kësaj shoqërie. Pra, sipas subjektit, prezenca e tij nuk ka qenë e nevojshme për kryerjen e procedurave në fjalë.
37. Gjithashtu, janë evidentuar disa mbivendosje të periudhave të punësimit të subjektit. Konkretisht, subjekti ka rezultuar i punësuar pranë shoqërisë përmbarimore “****” sh.p.k., për periudhën janar 2013 – korrik 2013, ndërkohë që gjatë të njëjtës periudhë sipas të dhënave INPS-it, ka rezultuar (pjesërisht) i punësuar edhe në Itali.
38. Lidhur me sa më sipër, po në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se gjatë vitit 2012 ka qenë në asistencë “*Cassa integrazione guadagni in deroga (CIGD)*”. Pas përfundimit të asistencës duhet të bëhej ndërprerja e marrëdhënies së punësimit nga ana e punëdhënësit (vëllait), por sipas subjektit kjo është neglizhuar nga ana e vëllait të tij apo ekonomistit të tij. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se sikurse evidentohet nga deklaratimet e kryera për efekt kontributesh, për këtë periudhë të ardhurat kanë qenë minimale.
39. Për sa i përket mospërputhjes së konstatuar lidhur me punësimin e tij pranë Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkues shkurt 2014 – shtator 2014, ndërkohë që gjatë të njëjtës periudhë sipas të dhënave INPS-it, subjekti ka rezultuar (pjesërisht) i punësuar edhe në Itali, ai ka deklaruar se për këtë periudhë deklarimi është bërë nga ana e vëllait të tij, për efekt të të pasurit një marrëdhënie pune aktive në funksion të rinovimit të lejes së qëndrimit¹⁸.
40. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit për të krijuar gjendjen *cash* sipas deklarimeve të tij në deklaratat periodike të pasurisë, duke përllogaritur të ardhurat dhe shpenzimet e tij dhe të bashkëshortes, si dhe ato të nënës vetëm për periudhën e bashkëjetesës. Nga analiza e kryer është konstatuar se subjekti ka rezultuar me disponibilitet të mjaftueshëm financiar për krijimin e gjendjeve *cash* të deklaruara prej tij, siç paraqitet në tabelën në vijim.

ardhura nga paga si nd/ligjor në Gjykatën e Lartë (nëntor 2015 e në vijim), si dhe të ardhurat e bashkëshortes së tij nga punësimi pranë shoqërisë: (i) “****” sh.p.k. (janar 2012 – korrik 2012); (ii) **** sh.p.k. (tetor 2013 – prill 2015); (iii) **** Group sh.p.k., (maj 2015 – korrik 2016); (iv) **** sh.p.k. (prill 2017 – shtator 2023).

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2023.

¹⁷ Sipas shkresës nr. *** prot., datë 31.1.2024, të DPPSH-së.

¹⁸ Sipas të dhënave nga INPS, deklaratimet e kryera për efekt kontributesh nuk kanë rezultuar me pagesë.

Tabela nr. 2 – Analiza financiare për krijimin e gjendjes cash

Viti	Deri në 8.11.2015	2016
PASURI	1 003 904	115 198
Automjet "Opel Frontera"	200 000	
Ndryshim likuiditeti	3 904	15 198
Ndryshim likuiditeti cash	800 000	100 000
DETYRIME	0	0
PASURI NETO	1 003 904	115 198
Të ARDHURA dokumentuar	4 670 703	1 330 808
Te ardhura nga paga e subjektit	4 024 596	971 736
Te ardhura nga paga e b/shortit	646 107	359 072
Te ardhura nga pensioni i nwnws	627 140	
SHPENZIME	1 844 062	714 494
Shpenzime jetese	1 654 404	470 184
Shpenzime udhetimi	189 657	40 310
Shpenzime qiraje	0	204 000
Shpenzime te tjera	0	
Analiza dokumentuar	1 822 737	501 116

41. Gjithsesi, edhe nëse nuk do të përfshiheshin në analizë të ardhurat nga punësimi në Itali për periudhat për të cilat kanë rezultuar mbivendosje (i punësuar në të njëjtën kohë në Shqipëri dhe në Itali), sërish subjekti do të rezultonte me balancë pozitive.

KONSTATIME TË TJERA

1. Lidhur me vendbanimet e subjektit të rivlerësimit

42. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nga data 9.11.2015 që ka filluar detyrën si ndihmës ligjor e në vijim ka banuar në këto adresa:
- Në periudhën 1.12.2016 – 1.5.2017 ka banuar në apartamentin e ndodhur në rrugën "****", pallati "****", shkalla ***, kati ***, ap. ***, Tiranë, me qira sipas kontratës së datës 1.12.2016, të nënshkruar me pronarin e kësaj pasurie, shtetasin Edi Pashaj, kundrejt pagesës mujore në vlerën 17.000 lekë.
 - Në periudhën 1.5.2017 – 1.7.2019 ka banuar në adresën rruga "****", nd. ***, h. ***, ap. ***, Tiranë, me qira mujore në vlerën 17.000 lekë, sipas kontratës nr. ***, datë 24.4.2017, me shtetasin K. M.¹⁹. Kjo adresë është deklaruar nga subjekti edhe në deklaratën *Vetting*.
 - Nga data 1.7.2019 dhe në vijim (deklaruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2019 në ILDKPKI) subjekti ka deklaruar se banon në adresën "****", kompleksi "****", ***, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, Shqipëri. Pasuri e regjistruar pranë Agjencisë së Kadastrës, Drejtoria Rajonale Tiranë me nr. *** pasurie, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 91.3 m² (101.1 m² bruto), sipas certifikatës së pronësisë datë 8.9.2020²⁰.
43. Në pyetësorin nr. 2, subjekti ka sqaruar se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie familjare apo shoqërore dhe as nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin E. P. dhe

¹⁹ Referuar kontratës së porosisë nr. ***, datë 29.2.2016, z. M. ka qenë në cilësinë e porositësit; kontratë qiraje nr. *** kol., datë 24.4.2017, me palë: qiradhënësi K. M. dhe qiramarrës Besmir Rrapaj me objekt "Dhënie me qira objekti në adresën ****".

²⁰Certifikatë pronësie datë 8.9.2020; kartela e pasurisë së paluajtshme për apartamentin me sip. 91.3 m², adresa: "****" në emër të shtetasve Besmir Rrapaj dhe L. L. Rr.; harta treguese e pasurisë; kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.2.2024, e Gjykatës së Lartë.

shtetasin K. M. Deklarimi i subjektit është konfirmuar edhe nga Gjykata e Lartë²¹, e cila, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka bërë me dije se nuk kanë rezultuar çështje të trajtuara nga subjekti ku shtetasit e mësipërm të kenë qenë palë.

44. Në përfundim të sa më sipër, nuk janë konstatuar problematika lidhur me vendbanimet e deklaruara nga subjekti.

2. Lidhur me udhëtimet e kryera nga subjekti

45. Gjatë hetimit Komisioni ka administruar²² të dhënat nga sistemi TIMS lidhur me udhëtimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit. Po ashtu, subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka deklaruar udhëtimet e tij dhe të anëtarëve të familjes së tij jashtë Shqipërisë. Nga verifikimi i të dhënave të administruara dhe atyre të deklaruara nga subjekti rezultoi se gjatë periudhës së rivlerësimit në datat 24 - 26 dhjetor 2016, subjekti ka kryer një udhëtim me destinacion në Dubrovnik, Kroaci, i shoqëruar nga bashkëshortja L. Rr. dhe shtetasit E. J. dhe O. M. J. Për sa i përket kostos së këtij udhëtimi, subjekti ka deklaruar se ato kanë qenë në vlerën 198 euro për hotelin, si dhe rreth 50 – 60 euro për shpenzime të tjera.
46. Po ashtu, nga të dhënat e sistemit TIMS janë konstatuar edhe disa udhëtime të kryera nga subjekti përgjatë viteve 2010 – 2013, si vijon:
- 17.12.2010 – 19.2.2010;
 - 28.5.2011 – 5.8.2011;
 - 24.9.2011 – 11.10.2011;
 - 7.11.2011 – 12.11.2011;
 - 9.3.2012 – 8.4.2012;
 - 13.6.2012 – 15.6.2012;
 - 28.10.2012 – 29.10.2012.
47. I pyetur nga Komisioni lidhur me udhëtimet e mësipërme, si dhe kostot e mbulimit të tyre, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se bëhet fjalë për udhëtime të kryera në funksion të pajisjes me leje qëndrimi në shtetin italian e, më pas, për të punuar në atë shtet pranë shoqërisë “***”, në pronësi të vëllait të tij. Subjekti ka deklaruar se ka paguar vetëm biletat e udhëtimit (avionit apo tragetit), ndërsa akomodimi si dhe kostot e qëndrimit janë mbuluar nga vëllezërit e tij E. Rr. dhe L. Rr., të cilët jetojnë në Itali prej më shumë se 30 vitesh.
48. Për sa më sipër, Komisioni ka përlogaritur shpenzimet e udhëtimeve të kryera nga subjekti dhe familja e tij bazuar në të dhënat e raportit të hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS, sipas metodikës në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit, si dhe deklarimeve të vetë subjektit në përgjigje të pyetësorëve. Rrjedhimisht, efektet financiare të këtyre shpenzimeve janë reflektuar në analizën e përgjithshme financiare në vitet përkatëse.

3. Lidhur me disa transaksione bankare të kryera nga subjekti²³

²¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2024.

²² Me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2024.

²³ Shkresa nr. *** prot., datë 22.2.2024, nga BKT-ja; shkresa nr. *** prot., datë 19.2.2024, nga Tirana Bank; shkresa nr. *** prot., datë 27.2.2024, sqaron se transaksioni i datës 15.3.2013 në vlerën 8.100 euro është tërheqje nga llogaria nr. IBAN *** e subjektit *** sh. a. me NIPT ***. Kjo tërheqje është kryer nga Besmir Rrapaj.

49. Nga AIF (ish-DPPPP) është bërë me dije për Komisionin se në emër të subjektit të rivlerësimit kanë rezultuar disa transaksione të kryera në BKT, Tirana Bank dhe Raiffeisen Bank lidhur me të cilat është administruar dokumentacioni nga bankat ku janë kryer transaksionet në fjalë. Konkretisht, nga BKT-ja²⁴ është përcjellë dokumentacioni, nga ku ka rezultuar sa vijon:
- tërheqje cash nga Besmir Rrapaj nga llogaria e *** me çek nr. ***, datë 6.4.2015, për shumën 1.500.000 lekë, në datën 7.4.2015;*
 - tërheqje cash nga Besmir Rrapaj nga llogaria e *** me çek nr. ***, për shumën 1.000.000 lekë, në datën 7.4.2015,*
 - tërheqje cash nga Besmir Rrapaj nga llogaria e *** me çek nr., nr. *** për shumën 1.500.000 lekë, në datën 15.5.2015.*
50. Po ashtu, nga Tirana²⁵ Bank është përcjellë dokumentacioni lidhur me transaksionin në vlerën 4.600 euro, të kryer në datën 31.3.2015, me përshkrimin “Tërheqje *cash* për shpërblim eksperti, pagesë çeku”.
51. Raiffeisen Bank²⁶, në përgjigje të kërkesës së Komisionit lidhur me transaksionin në vlerën 8.100 euro, të kryer në datën 15.3.2013, ka sqaruar se nga praktika e bankës tërheqja duhet të jetë bërë me çek, si dhe ka bërë me dije se nuk disponon dokumentacion pasi ka kaluar afati i ruajtjes në arkivin e bankës.
52. Gjithashtu, gjatë hetimit Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit lidhur me këto transaksione, i cili në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka shpjeguar se ato janë bërë në kuadër të dëmshpërblimeve nga aksidentet për llogari dhe në favor të të tretëve. Po ashtu, subjekti ka shpjeguar se nga këto transferta nuk ka përfituar asnjë tarifë dhe nuk ka gjeneruar asnjë e ardhur, pasi ato janë kryer në kuadër të marrëdhënieve shoqërore.
53. Në mbështetje të deklaramit të tij, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. ***, datë 26.2.2024, nga ***, me anë të të cilit vërtetohet se transaksionet e bëra për periudhën 2013 – 2015 nga z. Besmir Rrapaj janë pagesa dëmshpërblimesh në favor të personave të tretë të dëmtuar nga aksidentet.
54. Në vijim, i pyetur në lidhje me ndonjë dokumentacion ligjor që vërteton legjitimitetin (prokurë/autorizim) për kryerjen e transaksioneve të sipërcituara, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 subjekti ka deklaruar se as ai vetë, por as shoqëria për llogari të së cilës janë kryer transaksionet në fjalë nuk disponojnë asnjë dokument për shkak të kohës shumë të largët që ka kaluar. Në mbështetje të këtij deklarimi, ai ka paraqitur në cilësinë e provës përgjigjen e kthyer nga SIGAL²⁷, ku kjo e fundit bën me dije se nuk disponon dokumentacion, për shkak se ai është asgjësuar pas kalimit të afatit të ruajtjes 5 vjet.
55. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë subjekti nuk ka deklaruar të ardhura apo përfitime nga këto marrëdhënie, nëpërmjet të cilave të jetë vendosur ndonjë pasuri e caktuar, për rrjedhojë ato nuk mund të mund të bëhen pjesë e analizës financiare. Ky vlerësim i trupit gjykues arrin në këtë konkluzion duke mbajtur në konsideratë sa vijon: (i) të dhënat e përcjella nga banka, të cituara më sipër; (ii) faktin se subjekti ka bashkëpunuar me një zyrë përmbarimore “****” sh.p.k. për periudhën shtator 2012 – janar 2014,

²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.2.2024.

²⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2024.

²⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2024.

²⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 18.6.2024, nga ***.

dokumentuar kjo edhe sipas shkresës së ISSH-së²⁸; (iii) faktin se megjithëse veprimin e ka kryer subjekti, përfitues të pagesave kanë qenë persona të tretë; (iv) faktin se transaksionet e sipër përshkruara nuk e kanë impaktuar sferën financiare personale apo familjare të subjektit.

56. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni i ka gjetur bindëse dhe në përputhje me dinamikën e fakteve shpjegimet e subjektit se transaksionet e mësipërme janë kryer për llogari të të tretëve.

REZULTATET E ANALIZËS FINANCIARE

57. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare për çdo vit për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
58. Të ardhurat e deklaruara ndër vite dhe ato të dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit, paraqitur nga subjekti bashkëngjitur deklaratës *Vetting* dhe pyetësorëve.
59. Shpenzimet jetike janë përlllogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT-i.
60. Shpenzimet e udhëtimit janë përlllogaritur duke u bazuar në raportin e hyrje-daljeve sipas sistemit TIMS të subjektit dhe të anëtarëve të familjes së saj dhe bazuar në vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.5.2019, të Kolegjit dhe deklarimeve të vetë subjektit të në përgjigje të pyetësorëve.
61. Gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit dhe të anëtarëve të familjes.
62. Kursi i këmbimit i përdorur për shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.
63. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2015, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga ana e subjektit pranë ILDKPKI-së, nga ku ka rezultuar një bilanc pozitiv, siç është detajuar në tabelën më poshtë.

Analiza financiare për periudhën 2015 – 2016

²⁸ Me shkresën nr. 10412/1 prot., datë 19.12.2023.

Viti	Deri në 8.11.2015	9.11.2015-31.12.2015	2016
PASURI	1,003,904	-790,625	115,198
Automjet	200,000		
Ndryshim likuiditeti	3,904	-790,625	15,198
Ndryshim likuiditeti cash	800,000		100,000
DETYRIME	0	0	0
PASURI NETO	1,003,904	-790,625	115,198
Të ARDHURA dokumentuar	4,670,703	179,929	1,330,808
Të ardhura nga paga e subjektit	4,024,596	140,857	971,736
Të ardhura nga paga e b/shortit	646,107	39,072	359,072
Të ardhura nga pensioni i nënës	627,140		
SHPENZIME	1,844,062	108,759	714,494
Shpenzime jetese	1,654,404	74,759	470,184
Shpenzime udhëtimi	189,657		40,310
Shpenzime qiraje	0	34,000	204,000
Shpenzime të tjera	0		
Analiza dokumentuar	1,822,737	861,795	501,116
DIFERENCA E PA MBULUAR	0		

64. Në përfundim, nga hetimi administrativ i kryer, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të Komisionit nga subjekti i rivlerësimit rezultoi se ai në deklaratën *Vetting* ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
65. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Besmir Rrapaj ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

66. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë pranë Komisionit raporti nr. *** prot., datë 27.10.2017, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Besmir Rrapaj.
67. Gjithashtu, në vijim, nëpërmjet shkresës së datës 2.8.2022, organet ligjzbatuese i kanë bërë me dije Komisionit se nga verifikime të kryera nuk janë disponuar të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme të subjektit të rivlerësimit.
68. Në vijim të kërkesës së Komisionit për një përditësim e deklasifikim të raportit të tyre, AKSIK-ja, me shkresën e datës 4.6.2024, ka përcjellë pranë Komisionit raportin e sipërcituar të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, të KDZH-së, të datës 28.5.2024.
69. Gjatë hetimit, Komisioni është vënë në dijeni lidhur me një marrëdhënie interesi e familjare me një person të dyshuar si person i papërshtatshëm, që ndërthuret me veprimet për blerjen e një apartamenti nga subjekti në vitin 2018²⁹.
70. Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2019, si dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni, si adresë banimi pasurinë e ndodhur në “***”, kompleksi “***”,

²⁹ Ndonëse kjo pasuri është krijuar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*, po trajtohet këtu në funksion të analizimit të disa rrethanave që mund të ngrënë dyshime mbi kontakt të papërshtatshëm (të mundshëm).

***, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, Shqipëri. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti ka rezultuar se kjo pasuri është regjistruar në ASHK Tiranë me nr. *** pasurie, vol. ***, f. ***, z. k. ***, me sip. 91.3 m², sipas certifikatës së pronësisë datë 8.9.2020.

71. Po ashtu, në pyetësorin nr. 1 subjekti ka deklaruar se apartamentin në fjalë e ka blerë në datën 28.9.2018, në shumën 83.000 euro. Si burim për krijimin e kësaj pasurie ai ka deklaruar: (i) kredinë në shumën 65.000 euro, të marrë në Union Bank sipas kontratës me nr. ***, datë 28.9.2018; (ii) huan në shumën 15.000 euro nga shoqëria *** sh.p.k., sipas kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.9.2018 (e cila ka qenë në total në shumën 25.000 euro).
72. Po në këtë pyetësor, subjekti ka bërë me dije se bashkëshortja e tij ka qenë e punësuar në shoqërinë e sipërcituar përgjatë periudhës prill 2017 – shtator 2023 dhe se huadhënësi I. Rr., njëkohësisht dhe ortaku i vetëm i shoqërisë “****” sh.p.k., është kushëriri i tij.
73. Përgjatë hetimit, Komisioni është vënë në dijeni lidhur me ekzistencën e një njoftimi për shtyp të bërë nga SPAK-u, në datën 30.3.2024, në të cilin ndër të tjera citohej se: *“Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë ka përfunduar hetimet paraprake dhe ka paraqitur para Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar kërkesën për gjykim të procedimit penal nr. ***, viti 2020, në ngarkim të të pandehurve: I. Rr., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, e kryer në bashkëpunim, me pasoja të rënda, të parashikuara nga neni 143/2, 3 të Kodit Penal...”*.
74. Për sa më sipër, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 11.6.2024, Komisioni kërkoi informacion nga SPAK-u lidhur me akuzat që rendonin ndaj shtetasit I. Rr. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, me shkresën nr. *** prot., datë 19.6.2024, SPAK-u ka bërë me dije se në Prokurorinë e Posaçme është regjistruar procedimi penal nr. 13, viti 2020, për veprat penale të parashikuara në nenet 248-25, 143/2,3 dhe 186/3 të Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit I. Rr., etj. Pas përfundimit të hetimeve në lidhje me këtë procedim penal është vendosur të dërgohet në gjykatë me kërkesë për gjykim në ngarkim të të pandehurit I. Rr., i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, në bashkëpunim me pasoja të rënda, të parashikuara nga neni 143/2,3 i Kodit Penal dhe në ngarkim të të pandehurve të tjerë për vepra penale të tjera. Ky procedim, deri në datën e dërgimit të përgjigjes, është në fazën e gjykimit në seancë paraprake.
75. Në lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k., SPAK-u ka informuar se pas verifikimeve të kryera nuk ka rezultuar të jetë komunikuar akuzë ndaj personit juridik, por rezulton që ndaj kësaj shoqërie të jetë vendosur sekuestro preventive, sipas nenit 274 të Kodit Penal.
76. Nisur nga sa më sipër, si dhe bazuar në nenet 34 dhe 38 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, u krye vlerësimi nëpërmjet verifikimit të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim analizimin e rrethanave faktiko - ligjore dhe identifikimin e pasojave të mundshme ndaj këtij subjekti, pra nëse ai ka pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kritereve vlerësuese, të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nga dispozitat ligjore e nënligjore përkatëse.

77. Bazuar në nenin 3, pika 8 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *“Krim i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni përfshijnë veprat penale që sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale janë në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda ose të çdo gjykate tjetër që mund të zëvendësojë atë në ushtrimin e këtyre kompetencave”*.
78. Po ashtu, në nenin 3 të ligjit të sipërcituar, në pikën 15 të tij parashikohet se: *“Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata, pasi vepra penale është kryer nga një person që nuk mund të akuzohet ose dënohet”*.
79. Referuar pikës 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, parashikohet se: *“1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për: a) pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuar kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre; b) pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura, sipas parashikimeve të neneve 234/a dhe 234/b të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre; c) kryerjen e veprave të tjera, për qëllime terroriste, të parashikuara në pjesën e posaçme kreu VII i Kodit Penal; ç) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal; d) kryerjen e krimeve për qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, të parashikuara në nenet 114/a dhe 287 të Kodit Penal; dh) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 164/a, 244, 244/a, 245, 260, 312, 319 dhe 319/ç të Kodit Penal³⁰”*.
80. Nisur nga sa më sipër dhe nga verifikimet e vlerësimet e kryera mbi të dhënat e disponuara, është konstatuar se vepra penale e parashikuar në nenin 143/2/3 të Kodit Penal “Mashtrimi”, për të cilën akuzohet shtetasi I. Rr., nuk klasifikohet në rrethin e veprave penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të cilat cilësojnë një person (të proceduar për këto vepra) si të përfshirë në krimin e organizuar dhe, rrjedhimisht, si një kontakt të papërshtatshëm.

³⁰ 2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të: a) personave të afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, unjtë, emta, nipërit, mbesat, fëmijët e vëllezërve dhe të motrave, vjehrrit, vjehrra, dhëndri, nusja, kunata, kunati, bashkëjetuesi, thjeshtri, thjeshtra, njerku dhe njerka) të subjekteve të pikës 1 të këtij neni; b) personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, a janë përdorur, kanë lehtësuar apo në një formë kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni. 3. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes. 4. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji.

81. Gjithsesi, nisur nga dinamika e marrëdhënieve të interesave familjare, shoqërore me shtetasin I. Rr., të cilat mund të përmbajnë elemente për t'u vlerësuar në aspektin etik, Komisioni e ftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 3 të paraqiste shpjegime bindëse dhe shteruese lidhur me marrëdhënien, shkallën e afërsisë dhe frekuentimet me shtetasin I. Rr., si dhe në lidhje me njohjen apo përfshirjen e mundshme në aktivitetin tregtar të ushtruar prej tij.
82. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka shpjeguar se shtetasi I. Rr. është kushëriri i tij i dytë, me të cilin ka pasur marrëdhënie kryesisht përgjatë vitit 2017, kur bashkëshortja e tij u punësua pranë shoqërisë së tij "****" sh.p.k. Po ashtu, subjekti ka parashtruar se kontaktet me këtë shtetas kanë qenë kryesisht nëpërmjet telefonit për raste festash familjare dhe se komunikimi i fundit me të ka qenë rreth 2 vite më parë, ndërsa takimi i fundit nga afër mund të jetë edhe mbi 3 vite.
83. Lidhur me përfshirje të mundshme në aktivitetin tregtar të ushtruar nga shtetasi I. Rr., subjekti ka deklaruar se prej nëntorit të vitit 2015, për shkak të funksionit si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, e ka pasur të ndaluar me ligj ushtrimin apo kontributin në aktivitete të tjera private apo edhe shtetërore. Për më tepër, edhe vetë kushëriri i tij nuk ka pasur nevojë për ndihmën e subjektit dhe nuk i ka kërkuar asnjëherë asgjë.
84. Ndërsa, lidhur me bashkëshorten e tij, e cila ka qenë e punësuar pranë shoqërisë "****" sh.p.k. deri në datën 5.2.2024, kur ka dhënë dorëheqjen dhe është larguar nga detyra e juristes pranë kësaj shoqërie. Përveç sa më sipër, subjekti ka deklaruar se me këtë shoqëri ai dhe bashkëshortja kanë edhe një marrëdhënie detyrimi financiar, për të cilën ka vendosur në dispozicion edhe aktet noteriale dhe bankare përkatëse.
85. Në këto kushte, nisur nga sa është parashtruar më sipër, si dhe në analizë të rrethanave ligjore që cilësojnë ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm në referim të nenit 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë qenë i përfshirë në veprimtari të kundërligjshme apo të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

C/1. Lidhur me analizën e aftësive profesionale nga KLGJ-ja

86. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin e bashkëlidhur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Besmir Rrapaj, në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.
87. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në: (a) raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer dhe të përcjellë në Komision; (b) informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncimet dhe organet ligjzbatuese, burime, të cilat, kur ka qenë nevoja, i janë nënshtruar verifikimit të vërtetësisë së tyre nga Komisioni; (c) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
88. Raporti i përcjellë nga KLGJ-ja është kontrolluar në drejtim të saktësisë dhe të standardizimit të tij, raport i cili ka të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar

kritereve të vlerësimit, si: (i) aftësive profesionale; (ii) aftësive organizative; (iii) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (iv) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

89. Në të tetë dokumentet e vëzhguara nga KLGJ-ja ka rezultuar se ndihmësi ligjor Besmir Rrapaj, në çdo rast, ka evidentuar saktë dhe qartë rrethanat e mosmarrëveshjes, ka vlerësuar nëse rekursi është ushtruar brenda afatit ligjor, si dhe nëse rekursi i është drejtuar palës ndërgjyqëse respektive. Në relacionet e përgatitura prej tij nuk mungon analiza ligjore e vendimit gjyqësor ndaj të cilit është ushtruar rekurs, si nga pikëpamja e zbatimit të ligjit procedural, ashtu edhe në drejtim të zbatimit të ligjit material lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes.
90. Në lidhje me aftësitë organizative, etikës dhe angazhimit profesional të ndihmësit ligjor Besmir Rrapaj, nuk janë evidentuar problematika.

C/2. Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni

91. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGJ-së, si dhe dokumentacionin përkatës bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku dhe nga organet e tjera ligjzbatuese, si dhe ka analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
92. Pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLGJ-ja, mbi të cilin është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, Komisioni nuk ka konstatuar problematika.
93. Referuar të dhënave nga Shkolla e Magjistraturës mbi rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit Besmir Rrapaj, ku nga verifikimi i tabelave të rezultateve është konstatuar se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale “testi elektronik”, subjekti është vlerësuar me 51 pikë nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë “testi profesional” është vlerësuar me 143 pikë nga 200 pikë të mundshme.
94. Pas njoftimit të rezultateve të hetimit lidhur me konstatimet e KLGJ-së, subjekti, ndonëse nuk i janë kërkuar shpjegime, ka vlerësuar të parashtrorë se lidhur me tri çështjet administrative (relacionet), që ai ka përzgjedhur për vlerësim, vendimmarrja e Gjykatës së Lartë ka qenë në përputhje me propozimin e tij³¹, konkretisht:
95. Për çështjen administrative nr. *** akti, me palë paditëse *** ***, me të paditur Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 3.12.2015, ka vendosur: *Prishjen e vendimit nr. *** (***) , datë 14.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit*. Referuar relacionit të përgatitur nga subjekti, është konstatuar se ai kishte propozuar se kishte shkaqe ligjore dhe çështja objekt konflikti duhet t'i nënshtrohej shqyrtimit të juridiksionit gjyqësor.
96. Për çështjen administrative nr. *** akti, me palë paditëse M. K., me të paditur Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 3.3.2016, ka vendosur: *Lënien në fuqi të vendimit nr. *** akti, datë 20.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*. Edhe në këtë rast, vendimmarrja e

³¹ Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provave vendimet e Gjykatës së Lartë: vendimi nr. ***, datë 3.12.2015, i Gjykatës së Lartë; vendimi nr. ***, datë 3.3.2016, i Gjykatës së Lartë; vendimi nr. ***, datë 21.4.2016, i Gjykatës së Lartë.

Gjykatës së Lartë ka qenë në përputhje me propozimin e tij, pasi nuk kishte shkaqe ligjore për cenimin e vendimit dhe çështja objekt konflikti duhet t'i nënshtrohej shqyrtimit të juridiksionit gjyqësor.

97. Lidhur me çështjen administrative nr. akti ***, me palë paditëse *** sh. a., me të paditur Komuna ***, Korçë, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 21.4.2016, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 19.2.2013, të Gjykatës së Apelit Korçë dhe vendimit nr. ***, datë 18.9.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor”, ka rezultuar se vendimmarrja e Gjykatës së Lartë ka qenë në përputhje me propozimin e subjektit, pasi kishte shkaqe ligjore dhe çështja objekt konflikti nuk duhet t'i nënshtrohej shqyrtimit të juridiksionit gjyqësor.

DENONCIME NGA PUBLIKU

98. Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është paraqitur nga publiku një denoncim, i administruar me nr. *** prot., datë 15.9.2023, nga *** ***.
99. Ky denoncim është shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse të administruara bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e aspektit profesional të subjektit të rivlerësimit. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimin që është paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka rezultuar si më poshtë:
100. Denoncuesit kanë ngritur pretendime lidhur me kriterin e aftësive profesionale dhe me kriterin e vlerësimit të figurës. Për sa i përket nenit 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimi pranë Shkollës së Magjistraturës”. Denoncuesi parashtron faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të kualifikohet për ndjekjen e programit 2-vjeçar të trajnimit teorik dhe të praktikës profesionale pranë Shkollës së Magjistraturës, duke vënë kështu në dyshim aftësitë e tij profesionale. Lidhur me kriterin e figurës denoncuesi bën me dije se rezultoi një kallëzim penal nga Ministria e Drejtësisë për veprat penale “Mashtrimi”, me pasoja të rënda, të kryer në bashkëpunim dhe më shumë se një herë dhe “Shpërdorim detyre” kundrejt shoqërisë përmbartimore punëdhënëse e subjektit Besmir Rrapaj, duke vënë kështu në dyshim figurën e subjektit të rivlerësimit.
101. Me shkresën nr. *** prot., datë 24.1.2012, nga Komisioni drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme për informacion lidhur me rastet për ndjekje penale për subjektin Besmir Rrapaj Prokuroria e Përgjithshme³², me shkresën nr. *** prot., ***, datë 29.2.2024, dhe nr. *** prot., datë 30.1.2024, vuri në dispozicion informacionin e kërkuar, i ardhur nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm për subjektin Besmir Rrapaj, i cili rezultoi negativ dhe se nuk rezultojnë të regjistruara kallëzime/procedime penale në emër të subjektit.
102. Gjithashtu, Komisioni vëren se: “Këshilltari ligjor i Gjykatës Kushtetuese, ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, si dhe ndihmësi ligjor në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe

³² Shkresa nr. *** prot., datë 23.2.2024 nga Prokuroria është bërë me dije se për subjektin Besmir Rrapaj nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikat të procedimeve penale për periudhë kohore 2003-2024 nuk rezultoi që ndaj shtetasit të jenë regjistruar procedime në ngarkim.

b) *rezultatet e testimi pranë Shkollës së Magjistraturës*”. Vlerësimi i ndihmësve ligjorë pranë Gjykatës së Lartë do të kryhet edhe duke u bazuar në parashikimin e nenit 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. ***, datë 12.9.2014, të Kryetarit të kësaj Gjykate. Nga vlerësimi i kryer bazuar në këto kritere, nuk janë konstatuar problematika lidhur me aftësitë profesionale të subjektit. Gjithashtu, sikurse është përshkruar edhe më sipër, nga vendimi nr. ***, datë 21.5.2018, i Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, ka rezultuar se ndihmësi ligjor Besmir Rrapaj ka marrë në total 143 pikë nga 200 pikë që ishte maksimumi i parashikuar në tabelë, e kësaj ai është kualifikuar si i aftë për të vijuar në detyrën e ndihmësit ligjor.

103. Nga sa më sipër, ka rezultuar se pretendimet e ngritura në denoncimin në fjalë nuk gjenden të bazuara e, për rrjedhojë, nuk janë konstatuar problematika procedurale apo mangësi profesionale lidhur me veprimtarinë e subjektit.
104. Në konkluzion përfundimtar lidhur me kriterin e aftësive profesionale, Komisioni çmon se për subjektin e rivlerësimit nuk është konstatuar mangësi profesionale, për rrjedhojë z. Besmir Rrapaj ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Besmir Rrapaj:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Steven Kessler, në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Besmir Rrapaj, ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në datën 10.7.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI

Kryesuese

Lulzim HAMITAJ

Relator

Etleda ÇIFTJA

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Jonida Vrana